

FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PROSTACURE

Kapsula të forta me çlirim
të zgjatur – 0.4 mg
(Tamsulozin klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Çfarë përmban ky fletëudhëzues:

1. Çfarë është Prostate dhe përse përdoret?
2. Çfarë duhet të dini përpara se të merrni Prostate?
3. Si ta merrni Prostate?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Prostate?
6. Përmbajtja e paketimit dhe informacione të mëtejshme

1. ÇFARË ËSHTË PROSTATE DHE PËRSE PËRDORET?

Prostate përdoret në trajtimin e simptomave funksionale të hiperplazisë beninje të prostatës, të tilla si vështirësia në urinim.
Lënda vepruese e Prostate është tamsulozin. Tamsulozina është një bllokues i receptorëve alfa1, që redukton tensionin në muskujt e prostatës dhe uretrës. Në këtë mënyrë mundësohet një rrjedhje e lehtë e urinës përmes uretrës dhe lehtësohet urinimi.

2. ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË MERRNI PROSTATE?

Mos merrni Prostate:

- në qoftë se jeni alergjik nga tamsulozina apo nga ndonjëri prej përbërësve të tjerë të barit (të renditur në pikën 6)
- në qoftë se vuani nga hipotensioni ortostatik
- në qoftë se vuani nga një pamjaftueshmëri e rëndë e funksionit të mëlçisë.

Përkujdesjet gjatë përdorimit

Konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Prostate.
Në disa raste, gjatë trajtimit, mund të ketë rënie të presionit të gjakut që çon deri në të fikët. Nëse vini re shenjat e para të rënies së presionit të gjakut (p.sh. marrje mendsh, dobësi), duhet të uleni ose të shtrihen derisa simptomat të zhduken.
Përpara se të fillojë trajtimi, nëpërmjet ekzaminimeve të përshtatshme, mjeku duhet të përjashtojë

sëmundje të tjera që shkaktojnë të njëjtat simptoma si zmadhimi beninji i prostatës (hiperplazia beninje e prostatës).
Përpara se të fillojë trajtimi, dhe më pas në intervale të rregullt, mjeku duhet të bëjë ekzaminim me palpacion të rektumit dhe nëse është e nevojshme, përcaktimin e antigenit specifik të prostatës. Nevojitet kujdes i veçantë nëse keni çrregullim të rëndë të veshkave, me klirens të kreatinës < 10 ml / min., sepse nuk ka përvoja për këto raste.
Rrallë, është raportuar enjtje e indeve (angioedemë) pas administrimit të tamsulozinës. Nëse ju ndodh diçka e tillë gjatë trajtimit, ndërpriteni menjëherë marrjen e tamsulozinës dhe këshillohuni me mjekun.
Nëse jeni duke ju nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale në sy për shkak të kataraktit (turbullim i shikimit), ju lutemi të informoni mjekun tuaj specialist të syve para operacionit, që ju jeni duke përdorur ose keni përdorur më përpara Prostate. Kjo është e nevojshme sepse tek disa pacientë që kanë qenë nën trajtim ose janë trajtuar më parë me tamsulozinë, janë hasur vështirësi gjatë operacionit (p.sh. zgjerim i pamjaftueshmëri të pupilës, relaksim i irisit gjatë procedurës). Mjeku oftalmolog mund të marrë masat e nevojshme rreth mjekimit dhe teknikës së përdorur gjatë kirurgjisë. Pyesni mjekun nëse duhet ta shtyni apo ta ndërprisni përkohësisht trajtimin për shkak të kirurgjisë së kataraktit.

Marrja e Prostate me ushqim dhe pije

Prostate duhet të merret pasi të hani mëngjesin ose pas vaktit të parë të ditës, me një gotë ujë.

Fëmijët

Mos ja jepni këtë bar fëmijëve dhe adoleshentëve nën moshën 18 vjeç sepse nuk është efikas në këtë grupmoshë.

Shtatzënia, ushqyerja me gji dhe fertiliteti

Prostate përdoret vetëm në pacientët meshkuj. Ka raportime për çrregullime të ejakulacionit, ejakulacion retrograd dhe mosarritje të ejakulacionit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna të vlefshme nëse tamsulozina ndikon negativisht në aftësinë për të drejtuar automjetin ose për të përdorur makineri. Megjithatë, duhet të jeni në dijeni të faktit se Prostate mund të shkaktojë marrje mendsh.

Barnat e tjera dhe Prostate

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit ose do të merrni / përdorni ndonjë bar tjetër. Përdorimi i njëkohshëm i tamsulozinës me të tjerë bllokues të receptorëve alfa1 (p.sh. prazosinë, alfuzosinë), mund të shkaktojë hipotension. Diklofenaku (një analgjezik antiinflamator) dhe varfarina (e përdorur për hollimin e gjakut) mund të ndikojnë metabolizimin e Prostate në trupin tuaj.

3. SI TA MERRNI PROSTATE?

Gjithmonë ky bar merret ekzaktesisht si ju thotë mjeku juaj. Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni të sigurt.
Doza e rekomanduar është një kapsulë në ditë.

Prostate duhet të merret pasi të hani mëngjesin ose pas vaktit të parë të ditës, me një gotë ujë.
Kapsula duhet të gëlltitet e tëra, ndërkohë që jeni ulur ose në këmbë (jo në pozicionin e shtrirë). Kapsula nuk duhet përtypur pasi kjo do të ndërhyjë në çlirimin e modifikuar të lëndës vepruese.
Nëse keni përshtypjen se efekti i Prostate është shumë i fortë ose shumë i dobët, konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Në qoftë se keni marrë më shumë Prostate

sesa duhet

Në qoftë se keni marrë më shumë Prostate sesa ju përshkruan mjeku, kontaktoni mjekun tuaj ose spitalin.

Në qoftë se keni harruar të merrni Prostate

Në qoftë se keni harruar ta merrni barin pasi keni ngrënë mëngjesin, mund ta merrni më vonë në të njëjtën ditë. Në qoftë se harroni një dozë, merreni dozën në ditën në vijim.
Nëse keni pyetje të tjera mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjerë, ky bar mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Gjatë përdorimit të tamsulozinës janë raportuar efektet e mëposhtme anësore:

Të zakonshme: mund të ndikojë deri në 1 në 10 njerëz

Marrje mendsh, çrregullime të ejakulacionit, ejakulacion retrograd, mosarritje e ejakulacionit, një formë e veçantë e sindromës së pupilës së vogël (sindroma e irisit dembel [IFIS], që mund të ndodhë gjatë kirurgjisë së kataraktit).

Të pazakonta: mund të ndikojë deri në 1 në 100 njerëz

Dhimbje koke, palpitacione, marrje mendsh sidomos kur ngrihesh në pozicion ulur ose ngrihesh në këmbë nga pozicioni i shtrirë (hipotension ortostatik), rinit, konstipacion, diarre, të përziera, të vjella, skuqje e lëkurës, prurit, urtikarie, dobësi.

Të rralla: mund të ndikojë deri në 1 në 1.000 njerëz
Të fikët, angioedemë.

Shumë të rralla: mund të ndikojë deri në 1 në 10.000 njerëz

Sindroma Stevens-Johnson, priapizëm (ereksion i vazhdueshëm dhe i dhimbshëm).

Të panjohura: frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme

Shikim i turbullt, çrregullime të shikimit, çrregullime të rrahjeve të zemrës (fibrilacion atrial, aritmi), rritje të rrahjeve të zemrës (takikardi), marrje fryme (dispne), gjakrrjedhje nga hundët (epistaksis), inflamacion i lëkurës (eritema multiforme, dermatit eksfoliativ), tharje goje.

Nëse ju shfaqet ndonjë efekt anësor, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj, përfshirë edhe ndonjë efekt anësor tjetër që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues.

5. SI TA RUANI PROSTATE?

Ruajeni barin larg fëmijëve.
Ruajeni në paketimin original.
Mos e ruani mbi 30°C.
Mos e përdorni barin pas datës së skadencës të shënuar në blister dhe në kuti.

6. PËRMBAJTJA E PAKETIMIT DHE INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Çfarë përmban Prostate

Lënda aktive është tamsulozin klorhidrat.

Çdo kapsulë me çlirim të zgjatur përmban 0.4 mg tamsulozin klorhidrat.

Lëndët ndihmëse janë:

Përmbajtja e kapsulës: algjinat natriumi, kopolimer (1:1) acid metakrilik – etil akrilat, glicerinë dibehenat, maltodekstrinë, laurilsulfat natriumi, makrogol, polisorbat, hidroksid natriumi, emulsion i simetikonit (*simetikon*, *metilcelulozë*, *acid sorbik*), dioksid silici koloidal.

Përbërja e kapsulës: xhelatinë, oksid hekuri i kuq, dioksid titani, oksid hekuri i verdhë.

Përmbajtja e paketimit

Prostate disponohet në blistera, në kuti me nga 20 dhe 30 kapsula.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuësi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2023.

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please
check or uncheck the specific layers.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm